

VENDIM
Nr.441, datë 9.6.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 730, DATË. 6.11.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE
PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË
KËSHILL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 6, 9 e 10 të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 17 të vendimit nr.730, datë 6.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) zhvillimin e seminareve dhe të workshop-eve kualifikuese tripalëshe.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha